



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 28/15

Prishtinë, më 22.07.2015, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Ilir Deda, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe Bardhyl Meta.

Munguan: Safete Hadergjonaj dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të ftuar: Avdullah Hoti – Ministër i Financave dhe Agim Krasniqi – Zëvendës-ministër i Financave.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Rejhane Zylfijaj

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Merita Zogjani (Praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me Vendimin e Qeverisë për ndryshimin e normës së tatimit të akcizës;**
- 3. Rishqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-15 për Letërnjoftimin dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-23 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-25 për shëndetin mendor dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**
- 6. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – njoftoi anëtarët se në Komision janë proceduar amendamentet e komisionit funksional lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Markat Tregtare dhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Patenta. Meqë këto projektligje nuk përmbajnë kosto buxhetore shtesë, po ashtu as amendamentet, propozojë që të radhiten për shqyrtim në mbledhjen e sotme.

Kryetari konstatoi se Komisioni, miratoi rendin e ditës me plotësime: Shtohen dy pika të reja 6 dhe 7 si vijon: Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligji Nr.04/L-026 për Markat Tregtare me amendamentet e Komisionit funksional për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri, dhe Shqyrtimi i Projektligjin Nr.05/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligji Nr.04/L-029 për Patenta me amendamentet e Komisionit funksional për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri. Pika 6 bëhet pika 8.

2. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për konsultim më Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me Vendimin e Qeverisë për ndryshimin e normës së tatimit të akcizës

Avdullah Hoti - njoftoi anëtarët e komisionit, se Qeveria ka marrë vendim për ndryshimin e normës së akcizës në produktet që kanë të bëjnë me lojërat e ndryshme të fatit. Po ashtu është vendosur akciza për 18% e vlerës së tiktave të shitura për çdo muaj kalendarik për Lotarinë e Kosovës. Si dhe është propozuar që të vendoset norma e akcizës në shumë prej 2 euro për kilogram për fishekjarrët, raketat ndriçuese për sinjale, raketa për kohë shiu, sinjalet për mjegull dhe artikuj tjerë piroteknikë. Në bazë të ligji, vendimi i është dërguar komisionit për konsultim.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatojë se Komisioni njëzëri (në votim nuk ka marrë pjesë deputeti Ilir Deda), nxori këtë

Përfundim

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa, përkrahu Propozim-Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dt. 22.7.2015 për ndryshimin e normave të akcizës dhe shtimin e listës së mallrave që do ti nënshtrohen normës së tatimit të akcizës, si vijon:
 1. Vendoset norma e tatimit të akcizës në shumë prej 2€ për kilogram për fishekjarrët, raketat ndriçuese për sinjale, raketa për kohë shiu, sinjalet për mjegull dhe artikuj të tjerë piroteknike me kodin tarifor 3604.
 2. Vendimi Nr. 16/20 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 24.03.2015, paragrafi 4, nën paragrafi 2 ndryshohet si vijon, dhe pjesa tjetër e paragrafit 4 mbetet e pandryshuar.
- 240220 Cigaret që përmbajnë duhan në shumë prej 38€ për 1000 copë/cigare.
 3. Vendoset norma e tatimit të akcizës për Lojërat e Fatit si vijon:
 - 3.1. Kazinotë 7,000.00 (shtatë mijë) euro për çdo muaj kalendarik.
 - 3.2. Lojërat elektronike dhe slot-makinat tjera të vendosura në mjediset e kazinosë - 700.00 (shtatëqind) euro për çdo muaj kalendarik, për çdo kompjuter, makinë elektronike apo slot-makinë.
 - 3.3. Makinat elektronike me më shumë se një pozicion - 700.00 (shtatëqind) euro për çdo muaj kalendarik, për çdo pozicion.
 - 3.4. Baste sportive / subjektet që organizojnë baste sportive - 840.00 (tetëqind e dyzet) euro për çdo muaj, për çdo pikë të shitjes së biletave (basteve sportive).
 - 3.5. Operatorët (subjektet) e lojërave me automate - 700.00 (shtatëqind) euro për aparat, për çdo muaj kalendarik.
 - 3.6. Ruletë për makinat elektronike me më shumë se një pozicion - 420.00 (katërqind e njëzet) euro për çdo pozicion-ulëse në muaj kalendarik.
 - 3.7. Tombolat bingo në lokale të mbyllura 140.00 (njëqind e dyzet) euro për lokal për çdo muaj kalendarik.

- 3.8. Lotaria e Kosovës - 18% (tetëmbëdhjetë përqind) të vlerës së tiketave të shitura për çdo muaj kalendarik.
- 3.9. Lojërat Keno 18% - (tetëmbëdhjetë përqind) të vlerës së tiketave të shitura për çdo muaj kalendarik, sipas raportit të qarkullimit nga Lotaria e Kosovës.

3. Rishqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-15 për Letërnjoftimin dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së

Kryetari - sqarojë se projektligji nuk prodhon kosto shtesë buxhetore, po ashtu edhe amendamente e komisionit funksional përmbajnë implikime buxhetore shtesë dhe për këtë komisioni ka dhënë rekomandimet edhe më herët.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

- I. Projektligji nr. 05/L-15 për Letërnjoftimin, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
- II. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, dhe amendamentet e propozuara nga deputeti Nait Hasani, për Projektligjin nr. 05/L-15 për Letërnjoftimin, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-22 për Armë dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së

Kryetari - sqarojë se Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave ka konstatuar se projektligji nuk prodhon kosto shtesë buxhetore, po ashtu edhe amendamente e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

- I. Projektligji nr. 05/L-22 për Armë, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
- II. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, për Projektligjin nr.05/L-22 për Armë, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-23 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri dhe amendamenteve Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Kryetari - sqarojë se Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave ka konstatuar se projektligji nuk prodhon kosto shtesë buxhetore, po ashtu edhe amendamente e komisionit nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

- I. Projektligji nr.05/L-23 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

- II. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për nr.05/L-23 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-25 për shëndetin mendor dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Kryetari - sqarojë se ky projektligj përmban implikime buxhetore shtesë ku sipas Departamentit të Buxhetit për vitin 2015 dhe 2016 kostoja shtesë është vlerësuar 565,000 euro, që do të duhej të mbulohen nga institucioni përgjegjës që në këtë rast është Ministri e Shëndetësisë.

Avdullah Hoti – zbatimi i ligjeve duhet të bëhet brenda ndarjeve buxhetore të secilës organizatë.

Kryetari – me amendamentin 41 të komisionit funksional ku është reformuar neni 32 i projektligjit është paraparë që në afatin brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji, qeveria dhe ministrinë përkatëse të nxjerrin aktet nënligjore dhe mendojë që gjatë kësaj faze do të duhej të trajtohej edhe kostoja buxhetore e këtij ligji.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

- I. Projektligji nr.05/L-25 për Shëndetin Mendor, përmban kosto buxhetore të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
 - II. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, për Projektligjin nr.05/L-25 për Shëndetin Mendor, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligji Nr.04/L-026 për Markat Tregtare dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

Kryetari - sqarojë se Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave ka konstatuar se projektligji nuk prodhon kosto shtesë buxhetore, po ashtu edhe amendamente e komisionit nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

- I. Projektligji Nr.05/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Nr.04/L-026 për Markat Tregtare, nuk përmban kosto buxhetore shtesë.
 - II. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për Projektligjin Nr.05/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Nr.04/L-026 për Markat Tregtare, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
- 7. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligji Nr.04/L-029 për Patenta dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

Kryetari - sqarojë se Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave ka konstatuar se projektligji nuk prodhon kosto shtesë buxhetore, po ashtu edhe amendamente e komisionit nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatojë se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

- I. Projektligji Nr.05/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligji Nr.04/L-029 për Patenta, nuk përmban kosto buxhetore shtesë.
- II. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për Projektligjin Nr.05/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligji Nr.04/L-029 për Patenta, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

8. Të ndryshme

Enver Hoti – meqë do të miratohet ligji për faljen e borxheve, kërkojë që ministria e financave të sjellë listën e të gjithë atyre që do të përfitojnë nga ky ligj.

Latif Gashi – ligjet miratohen në interes të të gjithë qytetarëve, prandaj edhe me Ligjin për faljen e borxheve, do të përfitojnë të gjithë qytetarët.

Naser Osmani - Ligji për Faljen e Borxheve është i thjeshtë dhe i kuptueshëm dhe në të mirë të gjithë qytetarëve që do të përfitojnë nga ky ligj. Ajo që kuptova nga deputeti Hoti, ishte një kërkesë që të sillet një listë e përfituesve nga ministria për komisionin. Por ligji e përcakton qartë se brenda tridhjetë ditësh pas hyrjes në fuqi, të gjitha institucionet duhet të përgatisin listat e përfituesve.

Mbledhja përfundoi në ora 13:25

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani